

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË
FAMILJARE - PRISHTINË
Nr. 367 Dt. 14. 2. 2016
PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
Rr. "Fehmi Agani" nr.22 – Prishtinë

PRISHTINË

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë, në përputhje me nenin 8, të Ligjit mbi Marrëdhënjet e Punës Nr.03/L-212, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 14/2011 dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të QKMF-ës, publikon këtë:

K O N K U R S

Për pranim në marrëdhënie pune

1.TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Dy (2) Specialist i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

Detyra dhe përgjegjësitë:

- Bënë egzaminimin fizikë (inspektimin ,auskultimin ,palpimin, perkutimin),përdorë mjetet e punës (stetoskopin,tensiometrin,otoskopin ,oftalmoskopin,EKG..)vendos diagnozen e punës ,referon për analiza ,hulumtime diagnostike dhe konsulta specialistike ,cakton diagnozën përfundimtare ,trajton pacientin me terapi adekuate,bënë edukimin dhe promovimin shëndetësor ,këshillon pacientin,cakton terminin për vizitën e ardhshme dhe e plotëson kartelën shëndetësore .
- Bënë promovimin shëndetësor ,parandalimin ,diagnostifikimin ,mjekimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve ,çrregullimeve dhe lëndimeve .
- Ofron shërbime të kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Ofron shërbime të shëndetit riprodhues duke e përfshirë edhe planifikimin familjar.
- Kryen edhe punë të tjera nga lëmia e mjekësisë familjare sipas urdhërit të shefit.
- H-27, Koeficienti – 8.40
- Orari: - 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit sipas Ligjit të punës nr. 03/L-2012

Kushtet e Konkursit:

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të kryer Specializimin nga Mjekësia Familjare dhe Licencën e Punës.

2. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Tre (3) Doktor të Mjekësisë , në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

Detyra dhe përgjegjësitë:

- Pranon pacientin nga infermiera, shënon të dhënat e duhura në kartelën shëndetësore, merr anamnezën , bënë auskultimin dhe palpacionin e pacientit ,bënë reanimimin kardio pulmonar,bënë ekzaminimin e shpinës dhe ekstremiteteve ,referon pacientin për hulumtime të duhura ,cakton diagnozën, trajton pacientin me terapi adekuate ,cakton vizita konsultative, të gjitha shërbimet shëndetësore që kryhen në mbrojtjen primare. Për punën e vet i përgjigjet shefit.
- H – 20, koeficienti 7.20
- Orari: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: sipas ligjit të punës nr. 03/L-2012 Kushtet e konkursit:

Kandidatët të cilët konkurojnë për këtë vend të punës përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të kryer Fakultetin e Mjekësisë së përgjithshme dhe Licencën e Punës.

3.TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Dy (2) Doktor të Stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

Detyra dhe përgjegjësitë:

- Bënë promovimin dhe edukimin mbi shëndetin oral.
- Bënë parandalimin e sëmundjeve të gojës dhe dhëmbit.
- Shëron dhëmbët karioz ,bënë flourizimin e dhëmbëve te femijët,ofron ndihmën e parë stomatologjike,kryen nxjerrjen e dhëmbëve,referon pacientin për vazhdim trajtimi te mjeku specialist dhe punë të tjera të parapara sipas sistematizimit të vendeve të punës .
Kategoria dhe grada e vendit të punës:
- H-20, Koeficienti – 7.20
- Orari: - 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit sipas Ligjit të punës nr. 03/L-2012 Kushtet e Konkursit:

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të kryer Fakultetin e Mjekësisë – Drejtimi i Stomatologjisë dhe Licencën e Punës.

4. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: DY (2) Teknik të Dhëmbëve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Detyra dhe përgjegjësitë:

- Vendos kontaktin e parë me pacientin ,evidenton të dhënat e nevojshme mjekësore .E pregaditë dhe e mirëmbanë aparaturën stomatologjike ,instrumentet dhe mjetet tjera për punë.Bashkëpunon me mjekun stomatolog dhe i ndihmon në të gjitha ndërmarrjet stomatologjike.I pranon masat e dhëmbëve nga mjeku dhe sipas udhëzimit të bashkangjitur i punon të gjitha llojet e protezave si për të rritur ashtu edhe për fëmije.Kryen edhe punë të tjera në bazë të kërkesës së mjekut.Për punën e vet i përgjigjet shefit .

Kategoria dhe grada e vendit të punës:

- H-68, Koeficienti – 4.80
- Orari: - 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit sipas Ligjit të punës nr. 03/L-2012 Kushtet

e Konkursit:

Kandidatët të cilët konkurojnë për këtë vend të punës përveq kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë dega e Stomatologjisë – Teknik i Dhëmbëve dhe Licencën e Punës.

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

- Aplikacioni merret dhe dorzohet ne Administratën e QKMF-së (nga ora 8-15),Rruga „Fehmi Agani” nr 22-Prishtinë.

- Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diploma, kopja e letërnjoftimit dhe Licenca e Punës çertifikatat e trajnimeve .

-Njohja bazike e punës me kompjuter e domosdoshme .

-Dokumentacioni i cili i bashkangjitet aplikacionit duhet te jete fotokopje dhe se i njehti nuk kthehet .

- Dokumentacioni i cili nuk i'u pergjigjet kërkesave dhe specifikave të konkursit si dhe dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai qe mbërrin me vonesë nuk do të shqyrtohen .

Me dt. 25.02.2016
Prishtinë